

LINDITA ÇIFÇI

**SINONIMIA TE FOLJET E PARME NË FJALORIN SINONIMIK  
TË GJUHËS SHQIPE 2004**

Folja në gjuhën shqipe është njëherazi, njësia leksiko-gramatikore ku mishërohen e zbulohen lehtësisht të gjitha dukuritë semantike dhe struktura e saj kuptimore përfshin shpesh më mirë se gjithë pjesët e tjera të ligjëratës gjithë zhvillimet kuptimore, të brendshme dhe të jashtme, të kushtëzuara e të pakushtëzuara, reale dhe mundësore, që kanë ndodhur në rrjedhë të shekujve në leksikon e shqipes. Kjo shpjegohet edhe me peshën kuptimore të fjalëve, edhe me gjerësinë e përdorimit të tyre. (Më shumë kuptime të reja marrin fjalët që kanë një jetë më të gjatë në përdorim, fjalët më të zakonshme, ato që lidhen me shumë fjalë të tjera.)

Meqenëse folja është klasa leksiko-gramatikore që përfshin mbi 30% të fjalësit të shqipes, ne jemi ndalur vetëm në sinoniminë e foljeve të parme të cilat nuk vendosin marrëdhënie sinonimie vetëm me folje të parme, por edhe me folje jo të parme, qofshin ato të prejardhura, të përbëra a të përngjitura, të krijuara me ndajshitesa apo pa ndajshitesa etj.

*Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*, 2004 është një pasuri kombëtare që ka regjistruar rreth 29.000 vargje sinonimike dhe përmban rreth 1000 folje të parme, të cilat kthehen në 1000 vargje a grupe sinonimike.

Kur ndalemi në tipologjinë semantike të kuptimeve të foljeve të parme në gjuhën shqipe, që hyjnë në marrëdhënie sinonimike me fjalë a me kuptime të ndryshme të një fjale tjetër, vërejmë se kuptimet janë të asaj tipologjie që janë edhe për fjalët e tjera të shqipes në përgjithësi.

Kuptimet e foljeve të parme mund të jenë "*të parme* dhe kuptime të *prejardhura*. Kuptim i parmë është kuptimi historikisht fillestar i fjalës, kuptimi me të cilin ajo ka hyrë në përdorim, që nuk ka ardhur nga ndonjë kuptim tjetër.

Kuptimet e foljeve mund të jenë kuptime *konkrete* dhe kuptime *abstrakte*. Dallimi i këtyre kuptimeve bëhet thjesht sipas natyrës së realieve që shënohen nga fjalët përkatëse dhe sipas mënyrës se si i perceptojmë ato realie. Pra, janë konkrete ato kuptime që u referohen realieve të perceptueshme me anë të shqisave.

Gjithashtu, kuptimet e foljeve të parme mund të jenë *të drejtpërdrejta* dhe kuptime *të figurshme*. Si kriter dallues i këtyre kuptimeve merret mënyra

si shënohet realia. Kur realia shënohet drejtpërdrejt, pa ndërmjetësinë e ndonjë realieje tjetër, atëherë te fjala emërtuese kemi kuptim të drejtpërdrejtë.”<sup>1</sup>

### **1. Sinonimia në kuptimet e para, kryesore, të mirëfillta të foljeve të parme**

Folja *qëlloj* në fjalor ka 9 kuptime nga të cilët kuptimi i parë është kryesori kurse të tjerët të prejardhur. Në kuptimin parë kjo folje hyn në sinonime me një varg sinonimesh prej 20 foljesh të tjera, të cilat janë të parme dhe jo të parme. Kjo tregon pasurinë e shqipes, por edhe mundësitë e saj të jashtëzakonshme për zhdërvjelltësi e larmi shprehësie e komunikimi, duke mënjeluar monotoninë dhe veçanërisht ambiguitetin (kuptimshmërinë e dyfishtë) të fjalëve a të kumteve.

Folja QËLLÓJ në kuptimin e parë të saj është sinonim me foljet: Godit, Godas, Bie, Shtie, Shkreh, Rrah, Shkopit, Vardoj, Qit, Quktis, Qepoj, Vesh, Gjuaj, Mbaj, Përvishem, Përmbaj, Vishem, Zë (me shqelma), Thek, Sëlloj.

### **2. Sinonimia në kuptimet e prejardhura, jo të para të foljeve të parme**

Foljet e parme në gjuhën e shqipe mund të kenë më shumë se një kuptim dhe po të analizojmë lëndë leksikografike nga fjalori vërejmë se të gjitha kuptimet e tyre jo të para (të prejardhura nga kuptimi i parë ose nga kuptime të tjera të prejardhura) hyjnë në marrëdhënies sinonimike dhe krijojnë vargje të shumta sinonimike. Kjo dukuri do të trajtohet më gjerë tek sythi për *polisinoniminë*. Më poshtë po japim kuptimet e prejardhura të foljes *prish* dhe vërejmë se kemi me dhjetëra sinonime të organizuara në vargje, pa përmendur këtu që sinonimet që jepen me shigjetë në vetvete kanë me dhjetëra e dhjetëra sinonime e vargje sinonimesh të nënkuptuara. **Folja PRISH** në të gjitha kuptimet e saj jo të para (janë 26 kuptime jo të para) krijojnë disa vargje sinonimike me 65 folje.

### **3. Sinonimia në kuptimet e drejtpërdrejta / Sinonimia në kuptimet e figurshme:**

LËVÍZ *kal.* 1. E shpie dikë a diçka në një vend tjetër. Luaj. *Babai nuk e luajti nga vendi govatën prej druri që po gdhendte. (Let. art.).* Zhvendos. Shtyj e lëviz duke përdorur një forcë. Ngas *krahin.* 2. → Lëkund<sub>1</sub> *kal.* 3. *jokal.,* edhe *fig.* → Lëkundem<sub>1,5</sub> *vetv.* 4. *jokal.* Shkoj në një vend ose në një drejtim të caktuar. Eci. *I pëlqente të ecte më këmbë deri aty, prandaj nuk hipi në makinë. (Pub.).* Shkoj. Vete. Kaloj. 5. *v. III.* → Kaloj<sub>2</sub> *jokal.* në *v. III.* 6. *jokal. zakon. v. III,* edhe *fig.* Ndryshon shpesh vendin, qëndrimin a gjendjen. Zhvendoset *vetv.* Shkoj (nga një vend në tjetrin). Lëkundet *vetv.* Luhatet *vetv.* Lëvrin. *Botërat janë pa anë, në to lëvrijnë qenie e sende gjithëfarëllojesh. (Pub.).* 7. *jokal. fig.* Shkoj përpara; *v. III.* ecën si proces. Përparoj. Shkoj. Eci. *Sipas tij, deri tani punimet po ecin mirë.*

<sup>1</sup> Për këtë lloj tipologjie kuptimore shih më gjerë J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 146-148.

(*Pub.*). Zhvillohet *vetv.* 8. *jokal.* I vihëm një pune, vihëm në lëvizje me vrull. Përvishem *vetv.* 9. *fig.* → Trondit<sub>3</sub> *kal. fig.* 10. *jokal. bised.* → Çmendem *vetv.*

#### 4. Sinonimia në kuptimet konkrete / Sinonimia në kuptimet abstrakte

Këtë tipologji kuptimore e kemi zbuluar në dy forma: brenda një foljeje të parme, ku kemi sinonimi të kuptimeve konkrete dhe sinonimi të kuptimeve të figurshme që janë përgjithësisht kuptime abstrakte, si te folja *ngjesh*. Por një folje mund të jetë vetë abstrakte (edhe pse në përgjithësi foljet mund të merren si me kuptim abstrakt), si te folja *fyej*. Po i japim foljet të marra nga **FSGJSH**:

##### 5. Sinonimia në kuptimet e përgjithshme

**FSGJSH** është fjalor që është hartuar mbi fjalorët normativë të shqipes standarde, të cilët përgjithësisht pasqyrojnë fjalë dhe kuptime që i takojnë leksikut të përgjithshëm ose me prirje për t'u bërë leksik i përgjithshëm (nëse i takojnë leksikut terminologjik ose shtresave të leksikut pasiv). Kështu folje bie tregon një pjesë të kësaj gjendjeje të sinonimisë së shqipes.

**BIE**<sub>1</sub> *jokal.* 1. Rrëzohem nga lart poshtë shpejt e zakonisht duke u përplasur diku

##### 6. Sinonimia në kuptimet terminologjike

**FSGJSH, 2004** ka shumë fjalë e kuptime terminologjike që hyjnë në sinonimi, edhe pse sinonimia nuk është tipar i leksikut terminologjik. Kjo tregon se këto fjalë a kuptime kanë prirjen të shterminologjizohen:

**THËRPËJ** *kal. veter.* → **Ndërzej**<sub>1</sub> *kal. veter.*

**THITH** *kal.* 3. Tërheq e nxjerr me pompë etj. lëngun, gazin etj. **Thëthij**. 4. *zakon. v. III.* E tërheq diçka (ujin, një lëng etj.) brenda vetes. **Thëthin. Pi.** *Në vazo hidhet një shtresë rërë, sepse rëra e pi ujin. (Let. më.s.). Përthith e thith tërësisht. *Organizmi i gjallë nuk i përthith njëlloj valët elektromagnetike. (Let. shkenc.).**

**Merr.** - *Leshi merr lagështi në bodrum, prandaj hiqe prej andej. (Ligj. fol.).* 8. → **Asimiloj**<sub>1</sub> *biol.*

##### 7. Sinonimia në kuptimet e gjalla, normative / në kuptimet e vjetruara

Sinonimet e një fjale mund të jenë të gjalla e të kenë përdorim të gjithanshëm në gjuhën letrare, sigurisht në stile të ndryshme. Fjala vjen sinonimia brenda strukturës kuptimore të foljes *vij* e ilustron këtë:

**VIJ** *jokal.* 1. Lëviz nga diku e arrij këtu; ecën dikush së andejmi këtej dhe arrin tek unë. Por sinonimia mund të vendoste dhe fjalë a në kuptime të vjetruara, që shihen si pjesë përbërëse e leksikut pasiv dhe përdoren vetëm si mjete me efekte stilistike:

**LËÇËT** *kal. vjet.* → **Lexoj**<sub>1</sub> *kal.*

##### 8. Sinonimia në kuptimet dialektore, krahinore, në ligjërimin e thjeshtë, në ligjërimin bisedor etj.

Këto kuptime dhe këto sinonime, meqenëse janë pasqyruar në një fjalor të shqipes standarde, kanë prirjen për t'u kthyer në kuptime normative. Në gjuhën shqipe kemi një larmi dubletesh leksikore, me burime dialektore, të

cilat luajnë rol te rëndësishëm, veçanërisht në letërsinë artistike. Shumë fjalë dialektore janë përjashtuar nga sistemi ynë gjuhësor duke e ngarkuar së tepërmi në mënyrë të panevojshme, sepse në përdorim të gjerë ka hyrë fjala e normës letrare, por kur nevojiten për arsye stilistikore ato dalin nga arkivi gjuhësor duke i dhënë ligjërit një ngjyrim karakteristik.

KĚRTÍLEM *vetv. krahin. a-u-ur* 1. **Kërcënohem** *vetv. 2. Vërsulem*<sub>2</sub> *vetv. fig.*  
ARSÉJ<sub>II</sub> *kal. krahin. 1.* □ **Përzë**<sub>1</sub> *kal. 2.* □ **Përfundoj**<sub>1</sub> *kal.*

BARKARÍS *kal. krahin. fig. keq. 1.* → **Degdis** *kal. 2.* → **Zhduk**<sub>3</sub> *kal.*

### 9. Sinonimia njëdrejtimshe

Sinonimia mund të jetë njëdrejtimshe kur folja e parme hyn në marrëdhënie vetëm me një folje tjetër. Kjo zakonisht ndodh kur foljet janë njëkuptimshe, të cilat zakonisht ose janë folje terma ose janë në marrëdhënie fjalë / fjalë shqipe :

ADOPTÓJ *kal. drejt.* □ **Birësoj** *kal. drejt.*

AKSELERÓJ *kal. libr.* □ **Përshejtoj** *kal.*

### 10. Polisinonimia

Në gjuhën shqipe, si në çdo gjuhë tjetër, ndeshemi me dukurinë që disa shenjues mund të jenë të lidhur me një nocion a kuptim dhe e kundërta-disa kuptime me një shenjues. Në të dy rastet krijohen fenomene të veçanta semantike gjuhësore të quajtura në gjuhësi si sinonimi dhe polisemi; dy fenomene të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Shkaku themelor i lindjes së tyre është i njëjtë dhe ka të bëjë me natyrën e jetës njerëzore që synon të zbulojë anë të reja të sendeve, të dukurive. Kjo jep mundësi që i njëjti objekt ose dukuri të emërtohet me fjalë të ndryshme. Këtë del edhe funksioni i sinonimeve për përcaktimin e përpiktë.

Pranohet se sinonimia rrjedh, gjithashtu dhe nga polisemantizmi i një njësie leksikore. Polisemia është një nga dukuritë semantike më të njohura dhe më të studiuara jo vetëm te ne. Ajo nënkupton aftësinë e fjalëve për të pasur më shumë se një kuptim, aftësinë për të na lidhur me më shumë se një realie nga mjedisi ku realizojmë veprimtarinë e përditshme.

Sinonimia ndeshet te foljet **njëkuptimshe** dhe te foljet **shumëkuptimshe** (dukuria e polisinonimisë). Foljet në gjuhën shqipe janë njëkuptimshe për arsye të ndryshme: janë folje të reja (të sapokrijuara), sidomos kur janë folje të formuara me përbërje, kur janë huazime, kur janë folje të formuara nga emra të shterminologjizuar, kur janë njësi që i takojnë leksikut krahinor apo dialektor, pra me shtrirje gjeografike të ngushtë, por që kanë prirjen për t'u bërë pronë e gjithë shqipfolësve, në një ligjërim a stil të caktuar etj.

Në se ndalemi te fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, si dhe te FSGJSH, 2004, do të vërejmë menjëherë se foljet shumëkuptimshe janë të shumta dhe ato tregojnë për një nga karakteristikat e gjuhës sonë edhe në këtë klasë njësisish për rritjen e aftësisë emërtuese të tyre, që me rrugë të ndryshme dhe

me mjete të larmishme gjuhësore të shënojnë me të njëjtën formë fonetiko-gramatikore më shumë veprime etj.

Polisemia, krahas krijimit të fjalëve të reja dhe huazimeve, është një nga mënyrat e pasurimit të sistemit leksikor e semantik. Si shfaqje e lëvizjes së brendshme kuptimore ajo shfaqet kryesisht me zgjerimin e strukturës kuptimore të foljeve dhe krahas pasurimit të këtij sistemi, është edhe rritje e forcës kumtuese e shprehëse të gjuhës. Në këtë vështrim çdo kuptim i ri që lind, është njësoj si çdo fjalë e re që formohet. Ndërkaq marrëveshja nuk vështrësohet, sepse fjalët përdoren në ligjërime të lidhura me fjalë të tjera e krijojnë kështu kontekste, brenda të cilave çdo fjalë hyn vetëm me një nga kuptimet e saj.

Gjuha shqipe ka shumë fjalë polisemike, e kushtëzuar ndër të tjera edhe nga dokumentimi relativisht i vonët i saj. Makrosistemi i foljeve shumëkuptimëshe shpesh të lë të habitur, duke përmbledhur në vetvete me dhjetëra kuptime, pa llogaritur ndonjë që nuk është dhënë ose pa llogaritur nuancat dhe ngjyrimet kuptimore që kanë lindur këta 30 vjetët e fundit dhe që nuk janë pasqyruar. Shqipja, si rrallë gjuhë tjetër, ka njësi foljore që i kalojnë të 40 kuptimet. Ne po japim më poshtë foljet me më shumë kuptime (duke u mbështetur te **FGJSSH**):

**bie** (prura) me 44 kuptime, **bëj** me 39 kuptime, **dal** me 35 kuptime, **shkoj** me 35 kuptime, **marr** me 34 kuptime, **vij** me 31 kuptime, **heq** me 31 kuptime, **vë** 30 kuptime, **zë** me 30 kuptime, **kthej** me 25 kuptime, **shtie** me 24 kuptime, **çel** me 23 kuptime, **vete** me 23 kuptime, **ngre** me 22 kuptime, **lë** me 22 kuptime, **jap** me 22 kuptime, **lidh** me 20 kuptime, **fut** me 20 kuptime, **hap** me 20 kuptime, **djeg** me 17 kuptime, **çoj** me 16 kuptime, **shkel** me 16 kuptime, **çoj** me 15 kuptime, **këput** me 13 kuptime, **tret** me 13 kuptime, **shpie** me 12 kuptime etj.

Që në pamje të parë të bie në sy që të gjitha këto folje janë njërrrokëshe, d. m. th. ato janë shumë të vjetra dhe i përkasin fondit themelor dhe shtresës aktive e të përgjithshme të leksikut të shqipes. Koha shumë e gjatë në përdorim i ka bërë që të kenë një numër kaq të madh kuptimesh.

Pasqyrimi i sinonimeve të ndryshme në strukturën kuptimore të një foljeje shumëkuptimëshe, njihet ndryshe si *dukuria e polisintonimisë leksikografike*. Kjo do të thotë se në analizimin dhe interpretimin e kuptimeve të ndryshme në një fjalë të tillë ne do të nisemi jo vetëm në shpjegimin që i bëhet fjalës, por edhe sinonimet përkatëse. Madje ka shumë fjalë që shpjegimi i tyre bëhet vetëm me disa sinonime duke mënjanuar llojet e tjera të shpjegimeve.

Nga FSGJSH, 2004 kemi folje me shumë kuptime dhe me dhjetëra sinonime: si **arrij** me 8 kuptime e 19 sinonime; **bëj** 21 kuptime e 92 sinonime; **bërtas** 4 kuptime e 16 sinonime; **bie** 31 kuptime e 123 sinonime; **bitis** 5 kuptime e 5 sinonime; **bluaj** 5 kuptime e 21 sinonime; **bredh** 4 kuptime e 16 sinonime; **brej** 3 kuptime e 18 sinonime; **brydh** 4 kuptime e 4 sinonime; **buçet** 5 kuptime e 31

*sinonime; buj 1 kuptim e 3 sinonime; buron 4 kuptime e 21 sinonime; çaj 5 kuptime e 18 sinonime; callëtis 2 kuptime e 7 sinonime; çel 7 kuptime e 26 sinonime; çoj 10 kuptime e 34 sinonime.*

Po sjellim si ilustrim këtu foljen *bëj*.

BËJ *kal.* 1. Kryej një veprim a merrem me diçka (në kuptim të përgjithshëm). **Veproj. Kryej. Zhvilloj.** Sinonimia në foljet e parme shumëkuptimëshe paraqitet me këto funksione kryesore:

a. Për të saktësuar më tepër shpjegimin e përmbajtjen kuptimore të saj me një fjalë që është më e njohur për shqipfolësin.

b. Njësia sinonimike në cilëndo formë me të cilën shprehet ajo (varg sinonimik apo shprehje frazeologjike) shërben si mjet i mëvetësishëm shpjegimi kuptimor p.sh.: pikas / diktoj, zbuloj, dalloj.

Folja shumëkuptimëshe mund të vendosë marrëdhënie *sinonimike tërësore (sinonimi të mirëfilitë) dhe jotërësore*. Në marrëdhëniet sinonimike tërësore foljet e vargut sinonimik krijojnë raporte me të gjithë elementet përbërës të vargut. Në realitet këto janë shumë të pakta sidomos në sistemin foljor të gjuhës shqipe, por megjithatë ndeshen edhe raste të tilla si folja *kapërcej* e cila ka 7 kuptime ku mund të numërohen gjithsej afërsisht 18 sinonime e në të 7 kuptimet e saj del në pah fjala *kaloj*.

Sinonimia jotërësore është në ato raste kur folja vendos marrëdhënie afrie edhe me grupet sinonimike e jo vetëm me tërë vargun sinonimik, pra ajo mund të hyjë në marrëdhënie sinonimie qoftë edhe me një fjalë të vetme të vargut, kurse në kuptimet e tjera mund të mos hyjë në raporte sinonimie. Kjo është një nga dukuritë më të pranishme të fjalorit. P.sh. folja e parme *nxjerr* del në fjalor në 15 kuptime nga këto folja me kuptimin *qit* del në kuptimin 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 10 dhe 12 ndërsa në kuptimin 8 del me grupin sinonimik grumbulloj (vullnetarë) Siguroj (kuadrin e duhur). Veçoj. Ndaj (pjesën më të mirë). Të cilat janë sinonime me njëra-tjetrën, por nuk mund të jenë sinonim me foljen qit. Në kuptimin 9 del vargu sinonimik **Siguroj** (fitime). **Përfitoj**. (*Pub.*) **Fitoj** (para), të cilat edhe këto janë sinonime me njëra-tjetrën, por nuk mund të jenë sinonim me foljen qit.

Marrëdhëniet sinonimike vendosen në kuptimet e drejtpërdrejta e në ato të figurshme. Sa më vëllimor të jetë makrosistemi i foljes, aq më shumë ka fjalë sinonime që qëndrojnë pranë kuptimeve të figurshme. Rritja e abstraksionit kuptimor dhe e figurshmërisë nga kuptimi në kuptim shoqërohen edhe me sinonime, për të mënjeluar paqartësinë e lidhjes me referentin, ambiguitetin kuptimor<sup>2</sup>.

<sup>2</sup> V. Memishaj, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.